

Les 7 règles d'or

1 Për të përshpejtuar shërimin e krahut të vaksinuar, lëreni atë zbuluar sa më shpesh që të jetë e mundur

2 Vishni rroba që nuk e shtrengojnë zonën ku jeni vaksinuar

3 Nëqoftëse ju del pak lëng nga vendi ku është bërë injeksioni, mjaft të vini një garzë të thatë

4 MOS VINI ASNJE POMADE, PUDËR APO NDONJË PRODUKT TJETËR në vendin ku ju është bërë injeksioni ose mbi ganglionin që është formuar.

5 Mos merrni asnjë antibiotik

6 Mund të bëni një banjë apo të laheni në dush që ditën e vaksinimit. Por, në rast se ju del pak lëng nga vendi ku ju është bërë injeksioni, mos u lani në pishinë ose në det


7 Konsultoni mjekun nëqoftëse :

- zona që duket e fortë në prekje (rreth zonës ku është bërë injeksioni) është më e madhe se 3 cm.
- nëse ndjeni pengesa në lëvizje
- ganglioni që ka dalë poshtë krahut duket me sy dhe është zbutur (lëshon lëng)

INFORMATION SUR LA VACCINATION PAR LE BCG

CENTRE DE LUTTE ANTI- TUBERCULEUSE DE LA MAYENNE (CLAT 53)

Centre Hospitalier
33 Rue du Haut Rocher
CS 91 525
53000 LAVAL
Tél : 02 43 66 50 55
Mail : clat53@chlaval.fr



Tuberkuloza

Tuberkuloza është një sëmundje ngjitëse që shkaktohet nga një bakterie që quhet bacili i Kokut. Ajo transmetohet tek njeriu nëpërmjet kollës apo cirkat e pështymës nga momenti që ata janë në kontakt të afërt dhe të shpeshtë.



Shenjat e sëmundjes janë sidomos kolla, ethet, lodhja, humbja e orkesit e shoqëruar me dobësim, djersitjet natën.



Vaksina BCG



BCG është një vaksinë që mbron kundër tuberkulozës. Që prej vitit 2007 kjo vaksinë nuk është më e detyrueshme. Ajo rekomandohet për fëmijët të cilët rrezikojnë shumë tuberkulozën që nga lindja deri në moshën 15 vjeç.

- Është një vaksinë e gjallë, e dobësuar.
- Kjo vaksinë ka kryesisht për qëllim të mbrojtë fëmijët e vegjël nga format e rënda të tuberkulozës në 75% të rasteve (meningjit tuberkuloz, tuberkulozë ushtarake).
- Vaksina as nuk mund ta ndalojë transmetimin e sëmundjes dhe as të përmbajë epideminë boëtrorë.
- Fëmijëve mbi moshën 3 muajshe u bëhet detyrimisht një test tuberkulinik (IDR) përpara se tu bëhet vaksina. Pas vaksinës nuk është më e nevojshme as të bëhet kontrolli IDR dhe as të vaksinohen sërish për BCG..
- Vaksina e BCG mund të injektohet në të njëjtën ditë me çdo lloj vaksine tjetër.

Rekomandimet e Vaksinimit

Ju këshillojmë të vaksinoni fëmijën tuaj që sapo lind dhe deri në moshën 15 vjeçare nëse:

- Jetoni në Ile de France (cilido qoftë departamenti apo kushtet e jetesës), në Guyane ose në Mayotte
- Fëmija juaj ka lindur në një shtet ku tuberkulozi është shumë i përhapur
- Fëmija juaj ka të paktën një prind të lindur një shtet ku tuberkulozi është shumë i përhapur
- Fëmija juaj do të qendrojë të paktën një muaj në një shtet ku tuberkulozi është shumë i përhapur
- Fëmija juaj ka precedentë të tuberkulozit në familje
- Fëmija juaj ndodhet në një situatë të cilën mjeku e konsideron të rrezikshme ndaj ekspozimit të bacilit tuberkuloz



Efektet dytësore të BCG

Zakonish, BCG-ja nuk shkakton reaksione të përgjishme, as temperaturë, as lodhje. Por mbas injeksionit, krijohet një puçër e zbehtë dhe lëkura merr hijen e një këkure portokalli. Ky reaksjon zhduket mbas disa minutash.



Në 48 orët e para mund të shfaqet një xhungë (skuqje dhe ngurtësim)



Tre muaj mbas vaksinimit, ndodh që vendi ku është bërë vaksina të ietë i ngurtë, me një plagë e cila mund edhe të nxjerri lëng. Shërimi i kësaj plage mund të zgjasi disa muaj. Mund t'ju dali gjithashu një ganglion nën sqetullën e krahut ku keni vaksinën.



Shenja e kësaj vaksine mbetet.